



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060104-50191 dt. 09/10/2023

PROCESVERBALI

I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur më dt. **20.09.2023**, ora 10:00.

Mbledhjen e kryesoi: Milaim Hajdari- Kryesues

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa ku të pranishëm ishin: Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, Kryesuesi i Kuvendit Milaim Hajdari, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Hamit Kastrati (PDK), Malsore Cakiqi (PDK), Azemine Bujupi Gjoka (DD), Hamit Haxhiu (DD), Arbër Halilaj (GREEN), Florentina Elezi-Veliu (VV) si dhe Drejtor të Drejtorive Komunale.

Komiteti filloi punimet më këtë:

Rend Dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i datës 24.08.2023.
2. Propozim vendimi i buxhetit të Komunës për vitin 2024 dhe parashikimi i buxhetit 2025-2026.
3. Propozim vendim për miratimin e projekt rregullores të programit komunal tre vjeçar për banim për periudhën 2023-2025 për Komunën e Glllogocit.
4. Propozim vendim për ndryshim plotësimin e rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në Komunën e Drenasit.
5. Draft propozim për ndryshim-plotësimin e rregullores për taksa tarifa, ngarkesa dhe gjoba.
6. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Drilona Krasniqit.
7. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Vanesë Avdullahu.
8. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Valmire Xhema Krasniqi.
9. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Shqiprim Hykolli.
10. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin Egzona Rustaj.
11. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin Kaltrina Gashi.
12. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin Arton Hasani.

13. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin Teuta Kuliqi.
14. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin Ganimete Ramadani.
15. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- pasi përshëndeti të pranishmit, kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa, ku prezantoi rendin e ditës, theksoi se kemi edhe tri pika shtesë për rend dite: 1. Raporti i Progresit për Implementimin e rekomandimeve të ZKA-së për vitin 2022. 2: Propozim vendim për ndarjen e parcelave kadastrale. 3. Propozim vendim për rialokim të mjeteve financiare.

Florentina Elezi-Veliu, ne si grup i LVV kemi kërkuar një raport nga Drejtoria e Shëndetësisë për disa informata apo skandale që kanë dalë në portale dhe mjetet tjera të informimit, kërkojmë një raportim për mbledhje të kuvendit.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, çka do që keni adresoni me shkrim dhe ne si ekzekutiv ju përgjigjemi në mbledhje mirëpo ne nuk e kemi për obligim me ju dhënë llogari mediave.

Florentina Elezi-Veliu, ajo që me pengon tek buxheti është përfshirja në kode i dy-tri fshatrave në një kod, unë kam kërkuar vazhdimisht një plan të brendshëm që ne si asamble me pas, unë prap sot po kërkoj një plan të brendshëm që për në seancë më na sjellë, cila rrugë është prioritet, cili projekt është me prioritet?

Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime u rekomandua rendi i ditës për mbledhjen e rregullt të Kuvendit Komunal, me 07 vota për, kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës: **2. Propozim vendimi i buxhetit të Komunës për vitin 2024 dhe parashikimi i buxhetit 2025-2026.**

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, buxheti i ka kalu gjitha fazat dhe ju ftoj që ta votoni në mbledhje të kuvendit është në të mirë të qytetareve të Komunës së Drenasit. Dëgjimet buxhetore kanë qenë për këtë çështje edhe takimet janë bërë në lokalitete të Komunës së Drenasit, punët janë përafër, disa projekte që mund të ngritën ju njoftoj që i kemi dërgua në kuadër të qeverisë me i zhvillu.

Florentina Elezi-Veliu, pa dyshim që kjo pikë është njëra ndër pikat më të rëndësishme për Kuvendin Komunal, ajo që mua më shqetëson është grumbullimi i fshatrave në një kod dhe me këtë jam pajtu, por unë kam kërkuar vazhdimisht një plan të brendshëm, prapë sot kërkoj një plan të brendshëm, psh cila rrugë është me prioritet, cili fshat ka prioritet pastaj ne e dina se çka me iu thënë qytetareve për ndryshe kjo nuk është aspak transparente kur i kemi dy e më shumë fshatra me një kod. Si mendoni ta votoj unë “për” kur nuk janë marrë aspak për bazë propozimet e mia kjo nuk është transparente.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, të përgëzoj për pjesëmarrjen në takime buxhetore, kërkesa juaj ka qenë subvencionimi për fëmijët në çerdhe private, dhe për subvencionim për lehonat nuk mund t'i bëjmë sepse nuk ma lejon ligji, buxheti është i komunës, nuk kemi të drejt, e keni planin e kryetarit të komunës.

Hamit Haxhiu, të njëjtin problem me segmentet e rrugës e kemi pas edhe vitin e kaluar, nëse ne e cekim që janë perfundu gjitha rrugët nuk e di atëherë ne çka kemi me investu, edhe vitin e kaluar kam qenë kundër buxhetit për arsye se nuk ka qenë i shpërndan ashtu siç duhet, ka kohë një javë që t'i kemi të specifikuara për cilat segmente është fjala, sa do të zgjas ai segment, dhe cilat janë prioritetet e fshatrave?

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, nuk e kemi implikua ne buxhet projektin e Qiqavicës, nuk e kemi implikua në buxhet rrugën e Berishës, Liqenin e Verbocit nuk i kemi implikua në buxhet sepse mendojmë me i realizua përmes buxhetit e nivelit qendror, ne kemi mbajtur takime me qytetar dhe po punojmë me qytetar dhe ky buxhet është për qytetaret e komunës tonë.

Hamit Haxhiu, ne raportojmë çdo tre muaj për projektet kapitale, ndërsa tani jemi duke e miratuar buxhetin për vitin 2024 dhe projektionet 2025-2026.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, ne e bëjmë planin e punës, në plan të punës e kam me ligj. Ne i kemi marrë kërkesat e qytetareve dhe i kemi implikua në buxhet, ne përveç asaj kemi bërë procesverbal, dhe çdo kërkesë ne jemi të obliguar me ju kthi përgjigje dhe nëse nuk i kemi kthi atë ditë e kemi për obligim me i kthi me shkrim dhe me i implikua në procesverbal e kemi të obliguar me ligj. Sa i përket kodeve që janë të vendosura në një vend është sepse kostoja e investimit të një tenderi për 30 m është shumë më e madhe se sa bashkë.

Bekim Dobra- Udhëheqës i zyrës për Informim, Kalendar i dëgjimeve buxhetore është përgatitur me kohë, sipas afateve ligjore dhe është publikuar në ueb faqen zyrtare të komunës, në platformën e konsultimeve publike në rrjetin social të facebook-ut si dhe janë kontaktuar të gjitha grupet e nen përfaqësuar për të qenë pjesë e këtij dëgjimi buxhetor. Komuna e Drenasit ka të hartuar edhe data bazën e të dhënave, ku është shfrytëzuar për të marr pjesë të gjitha grupet e interesuara. Komuna me kohë ka bërë njoftimin dhe ftesën. Që nga muaji Maj i këtij viti, pasi që kemi pranuar Qarkoren Buxhetore, kemi ftuar ekspertet, OJQ-të, Shoqërinë Civile dhe profesionistët për të kontribuar ne hartimin e këtij dokumenti. Ky dokument është përgatitur ne bazë të Qarkores Buxhetore të lëshuar nga Ministria e Financave, e cila paraqet përmbledhjen e kërkesave fillestare të planifikimit e parashikimit për vitin 2024 dhe projektionit të buxhetit për vitet 2025-2026. Komuna e Drenasit shquhet për transparencë e llogaridhënie, ndaj me kohë këto dy dokumente, Draft Kornizën Afatmesme Buxhetore 2024-2026 dhe draft-Listën e Investimeve kapitale i ka publikuar në ueb faqen zyrtare të Komunës. Ndjej për obligim të ju njoftoj me rregullat e takimit, që diskutimet për buxhet të jenë reciproke me qëllim që të behët një përmbledhje me interes për të gjithë qytetarët e Komunës së Drenasit. Pra, karakteri i këtij dëgjimi është që të jepni propozime, sugjerime dhe të diskutoni për planifikim të buxhetit për vitin e ardhshëm, por jo të jepni komente për projektet e këtij viti, ose viteve paraprake, sepse janë takime të tjera ato, kur qytetarët kanë mundësi të komentojnë projektet aktuale. Nga dëgjimet buxhetore që dalin kërkesat sugjerimet dalin vetëm ne raport, raporti pasi të përfundohet publikohet në ueb faqe zyrtare të komunës, kërkesat merren dhe dërgohen ne drejtori dhe evidentohen të gjitha kërkesat e qytetareve, raporti dhe procesverbali i dëgjimeve buxhetore i kërkesave të qytetareve evidentohet për secilin qytetar që ka bërë kërkesë, udhëzimi administrativ e cek që procesverbalet dhe raportet më i hartu raportet dhe procesverbalet dhe me i publikua në ueb faqe të komunës por nuk është e obligueshme me pru raportin në kuvend. Kryetari i komunës e ka bërë një vendim ku e ka formu grupin e punues për t'i mbajtur dëgjimet buxhetore dhe kuadër të grupit punues ne kemi hartu edhe një plan të

brendshëm por ai nuk publikohet sepse është plan i komisionit, dhe ne kemi punu në kuadër të planit të punës.

Azemine Bujupi-Gjoka, sa i përket listës së projekteve kapitale që e keni planifikua, brenda këtyre projekteve që janë përfshi dy tri fshatra në një kod, ne kërkojmë që me i ditë segmentet saktë sepse rrugët janë me emra dhe nuk është e vështirë, dhe ne duam saktë me e specifikua rrugën dhe jo me e përsërit të njëjtën si vitin e kaluar si tani të njëjta shuma, është e nevojshme një plan më i detajuar, se cilat segmente kanë me u shtrë cilat janë më prioritet.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, ju mundëni me thënë pse nuk e keni zhvillu një projekt sepse Qeveria KRPP dhe OSHP-ja nuk më lejon mua me e vazhdu një projekt përpara nëse unë nuk e kam bërë planin pasi të miratohet buxheti, tani jem duke shtrë rrugë alternative.

Pas diskutimeve, kritikave sugjerimeve kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: “për” votuan 7 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës: **3. Propozim vendim për miratimin e projekt rregullores të programit komunal tre vjeçar për banim për periudhën 2023-2025 për Komunën e Glllogocit.**

Lumnije Krapit- Drejtoreshë për shëndetësi, është hartu draft rregullorja, fillimisht është hartu draft rregullorja nga komisioni, ka kaluar procedurat e diskutimit publik, nuk ka pasur ndonjë koment brenda këtij afati kohor. Më Ligjin Nr.03/L-164 Për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit dhe Udhëzimet Administrative, të dala nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, si dhe Programin Komunal Tre Vjeçar për Banim Social 2023-2025, rregullohet çështja e Banimit të Përkohshëm Social, në mënyrë që t’u mundësohet zgjidhja e nevojave të banimit familjeve të caktuara të cilat nuk kanë mundësi ekonomike ta zgjidhin këtë problem.

Hartimi i Programit për Banimin Social 2023-2025, do të mundësojë kushtet për banim të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm për ato familje të cilat nuk e kanë zgjidhur çështjen e banimit dhe me forca vetanake e kanë të vështirë ta bëjnë një gjë të tillë.

Me aprovimin e Programit trevjeçar për Banimin Social, synojmë plotësimin e obligimeve ligjore dhe zbatimin e këtyre politikave të banimit në Komunën e Drenasit të ndërlidhet me procesin e integritetit evropian dhe me kriteret për anëtarësimin në BE duke respektuar Konventat Evropiane, Kartën Sociale dhe Deklaratën për të Drejtat e Njeriut.

Arbër Halilaj, e kam analizuar planin, disa sugjerime pasi që është draft tek pika 6 e këtij Draft plani ku është bërë analiza e gjendjes ekzistuese banesore mendoj se do të duhej të shtohet një raport jo vetëm për gjendjen e banimit social aktual por të raportohet saktësisht cilat janë objektet njësit banesore ku bartëse e drejte e pronësisë është Komuna Drenasit përveç dy objekteve të banimit social, kush janë banuesit aktual të banesave tjera në pronësi të komunës të përfituara nga ndërtimit në pronë komunale dhe cili është statusi apo mënyra e shfrytëzimit të tyre? Sugjeroj se pas një procesi të azhurnimit të databazës së të dhënave të banesës në pronësi komunale qofshin ato banim social apo forma tjera të shfrytëzimit informatat që dalin të bashkëngjiten në Draft-plan dhe t’i prezantohen asamblesë si pasqyre e gjendjes momentale. Tek pika 6. 4 ku cekën kategoritë e synuara mendoj se duhet të shtohen nenat vetushqyese apo mbajtëset e familjes që nuk e kanë të zgjidhura çështjen e banimit, ceket në draft plan edhe ndihma përmes bonuseve të banimit mendoj që është shumë pak 4-5 familje të ndihmohen me subvencionim të qiras në tri vitet e fundit mendoj se duhet gjetur

forma që të dyfishohet ky fond se paku për bonuse të banimit, mendoj që duhet të synohet shumë më tepër në këtë drejtim sa i përket kësaj çështje.

Lumnije Krapit- Drejtoreshë për shëndetësi, rekomandimet i kemi prit edhe gjatë diskutimit publik mirëpo edhe ato nëse janë të parapara me ligj mirëpo në faqen 38 e kemi si kategori kërkesat e nënave vetushqyese dmth është një ndër kriteret, janë kriter familjet me ndihmë sociale. Janë kushtet dhe kriteret e përcaktuara me ligj.

Pas diskutimeve dhe rekomandimeve që u dhanë kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, pika e rendit të ditës u rekomandua për mbledhje të rregullt me me 06 vota “për” kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës: **4. Propozim vendim për ndryshim plotësimin e rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në Komunën e Drenasit.**

Arben Shala-Nënkryetari i komunës: komisioni është duke vazhduar takimet për zgjedhjen e këshillave të fshatrave mirëpo nga puna në teren po kemi vështirësi po ka raste që kemi mungesë të koorumit për të paktën dy ose tri takime me rash duke pas parasysh që rregullorja nuk parasheh raste të tilla e kemi shikuar edhe një herë udhëzimin administrativ kemi kërkuar që të behet një plotësim i kësaj rregullore që të paktën që kur të thirret mbledhja për herë të tretë të zgjidhet kryesia e këshillit lokal të kryesuesit me personat e pranishëm që janë aty. Komisioni ka hasur në vështirësi në zgjedhjen e Këshillave Lokale për shkak të mungesës së kuorumit të paraparë me rregulloren përkatëse për disa takime me radhe për të njëjtin Këshill Lokal. Ndryshimet e kërkuara janë në përputhshmëri me *Udhëzimin Administrativ (MAPL) nr. 02/2019 Për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane* pasi që e njëjta nuk parashihet në udhëzimin e lartpërmendur.

Florentina Elezi-Veliu, për mua është pa pranueshme sepse mundet me qenë vetëm një person dhe me automatizëm mund me hy, kështu që mendoj që deri në mbledhjen e radhës me ardh me një ide tjetër dhe se paku të ketë një numër të caktuar të pjesëmarrësve.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, pajtohem me znj Elezi, sa i përket kësaj çështje mendoj se duhet të jete se paku një numër i caktuar i pjesëmarrësve.

Arbër Halilaj, propozoj që përfaqësimi të jetë i të gjitha lagjeve, për mos me ngec në proces.

Pas diskutimeve dhe rekomandimeve që u dhanë kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, pika e rendit të ditës u rekomandua për mbledhje të rregullt me me 07 vota “për” kundër nuk pati, abstenim nuk pati

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës: **5. Draft propozim për ndryshim-plotësimin e rregullores për taksa tarifa, ngarkesa dhe gjoba.**

Arbër Halilaj, fq 11 Prodhimi i çimentos shuma që është 10,000.00 dhe Prodhimi i betonit të përzier të gatshëm për përdorim 1,000.00 euro unë mendoj që kjo shumë është shumë e ulët sepse dihet kapaciteti e i këtyre kompanive që prodhojnë beton. Fq 15 zhvillimi i projekteve

ndërtimore, zhvillimi i projekteve ndërtimore, ndërtimi i objekteve banesore dhe jo banesore, ndërtimi i rrugëve dhe autostradave, ndërtimi i hekurudhave dhe i atyre nëntokësore-metrove, Ndërtimi i urave dhe tuneleve dmth operatorët që kanë kapacitet me i kry këto veprimtari mendoj se janë taksa shumë të ulta. Noterët dhe përmbartuesit i kisha dallu nga avukatura, dhe i kisha rrit taksat që janë të përballueshme.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, për kërkesat e juaja mund t'i ngritni në mbledhje të kuvendit.

Pas diskutimeve dhe rekomandimeve që u dhanë kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, pika e rendit të ditës u rekomandua për mbledhje të rregullt me me 07 vota "për" kundër nuk pati, abstenim nuk pati

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës: 6 deri tek pika 14 e rendit të ditës .

Azemine Bujupi-Gjoka, sa i përket ketyre propozim vendimeve, për subvencionim për pasije për qfar pasije është fjala me pas të specifikune sepse në bazë të arsyestimeve ishin të njëjta krejt.

Agnesë Kastrati-Bucolli, Drejtoreshë e zhvillimit Ekonomik: secili që ka aplikuar i ka sjellë edhe pro faturat për çfarë pasije ka aplikuar, mirëpo në propozim vendim nuk i kemi cek, pasi të është përzgjedh e hap biznesin dhe është në mbikqyrje nga komisioni përkatës nga drejtoria a është duke i mirëmbajtur pajisjet që i ka marrë, në të gjitha i kemi në raport.

Hamit Haxhiu, unë edhe vitin e kaluar kam kërkuar që pro faturën me e sjellë edhe në kuvend, prap i njëjti problem, çfarë biznesi është, a është i regjistruar, kërkoj që për ne mbledhje të rregullt me i sjellë gjitha këto kërkesa.

Agnesë Kastrati-Bucolli, Drejtoreshë e zhvillimit Ekonomik, afati i ankesave pas shpalljes publike është 5 ditë, ka pas të drejtë kush do që ka aplikuar për të bërë ankesë të cilat janë shqyrtuar nga komisioni i ankesave, në mungesë të dokumentacionit nuk kanë të drejtë me i shpall fitues. Shpallja është bërë edhe një herë sepse nuk ka pas aplikues sa ka pas buxhet të ndarë për këtë çështje.

Pas diskutimeve dhe rekomandimeve që u dhanë kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, pika e rendit të ditës u rekomandua për mbledhje të rregullt me me 07 vota "për" kundër nuk pati, abstenim nuk pati

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e pesëmbëdhjetë të rendit të ditës: **15. Raporti i Progresit për Implementimin e rekomandimeve të ZKA-së për vitin 2022**

Nuk pati diskutime rreth kësaj pike, Kryesuesi e hodhi në votim, dhe kjo pikë e rendit të ditës u rekomandua për mbledhjen e rregullt të Kuvendit Komunal.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e gjashtëmbëdhjetë të rendit të ditës: **16. Propozim vendim për ndarjen e parcelave kadastrale.**

Nuk pati diskutime rreth kësaj pike, Kryesuesi e hodhi në votim, dhe kjo pikë e rendit të ditës u rekomandua për mbledhjen e rregullt të Kuvendit Komunal

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e shtatëmbëdhjetë të rendit të ditës: **17. Propozim vendim për rialokim të mjeteve financiare.**

Nuk pati diskutime rreth kësaj pike, Kryesuesi e hodhi në votim, dhe kjo pikë e rendit të ditës u rekomandua për mbledhjen e rregullt të Kuvendit Komunal

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e shtatëmbëdhjetë të rendit të ditës: **18. Të ndryshme.**

Hamit Haxhiu, pyeti rreth çështjes të “Flutura Academy” a do t’i jepet objekti prap ne shfrytëzim.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, gjatë kësaj jave kanë kërkuar me e bërë komisionin për dorëzim pranim, “Flutura Academy” është në institucion jashtëzakonisht i mirë. Nuk do t’ia dhamë më në shfrytëzim objektin. “Flutura Academy.

Pasi nuk pati diskutime të tjera kryesuesi e konsideroj të mbyllur mbledhjen, mbledhja përfundoj rreth orës 12:00 min .

Procesmbajtëse:



Liridona Fejza-Ajazi



Kryesuesi i Kuvendit Komunal



Milaim Hajdari